

LIGJ
Nr. 35/2018

**PËR PAGESËN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA NË FAVOR TË BANKËS
EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Kryerjen e pagesës për aksionet e nënshkruara (*paid-in*) dhe të papaguara nga shteti shqiptar, të periudhës 1991–1998, që i përketin Rezolutës 15 - Anëtarësimi i Shqipërisë në vitin 1991, dhe Rezolutës 59 - Rritja e parë e kapitalit në vitin 1996, në favor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Neni 2

Shuma prej 1 288 348,27 (një milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e dyzet e tetë presje njëzet e shtatë) USD paguhet nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me një kësht, brenda vitit 2018.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 21.6.2018

Shpallur me dekretin nr. 10820, datë 28.6.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta